

**DEPARTEMENT
BILDUNG, KULTUR UND SPORT**

Vorsteher

Alex Hürzeler, Regierungsrat
Bachstrasse 15, 5001 Aarau
www.ag.ch/bks

Për

Prindërit e nxënësve të shkollës
Aargauer Volksschule

Albanisch

Maj 2020

Mësimi në shkollat fillore do të rifilloj duke nisur nga 11 maji 2020

Të nderuar prindër

Duke nisur nga dita e Hënë, 11. Maj 2020 klasat e shkollës fillore të Aargauer Volksschulen do të zhvillohen në ndërtesën e shkollës. Këshilli Federal ka marr këtë vendim më 29 Prill 2020 për të gjithë Zvicrën. Njëkohësisht Zyra Federale e Shëndetësisë (BAG) ka përcaktuar parametrat kyç mbi masat paraprake të mbrojtjes në shkolla. Faza e mësimi në disatancë do të mbyllet më 8 maj. Më pas fëmijët tuaj mund të rikthehen në kopshte, shkollat fillore ose shkollat e mesme.

Masat mbrojtëse

Masat mbrojtëse për rifillimin e mësimi bazohen në parametrat themelor të BAG, të cilat vlejnë për të gjithë territorin e Zvicrës. Ata kanë deklaruar se nuk ka rregulla të përcaktuara distancimi për nxënësit. Fëmijët dhe adoleshentët mund të qëndrojnë normalisht në klasë, të sillen dhe të lëvizin rrugës lirish për në shkollë dhe në vendet e pushimit.

Nga ana tjetër, nxënësit duhet të ruajnë një distancë minimale prej dy metrash në momentin kur komunikojnë me mësuesit e tyre sado të jetë e mundur. Mësuesit duhet të kenë parasysh rregullin e distancës prej dy metrash që vlen për të rriturit. Për më tepër, të gjithë personat që hyjnë në ndërtesën e shkollës duhet të respektojnë rregullat e higjenes (Duart-, higjena e objekteve dhe e sipërfaqeve, jo prekje me duar).

Përveç tualeteve që ekzistojnë bashkë me shpërndarësin e sapunëve të lëngshëm dhe letrat njëpërdorimëshe në ambiente të ndryshme si (në hyrje të shkollës, në biblioteka ose vende të tjera), disa opsione të tjera suplementare mbi higjenën e duarve janë të disponueshme në ndërtesën e shkollës, përfshirë dezinfektuesit e duarve. Gjithsesi, nxënësit dhe nxënëset duhet të përdorin desinfektantët vetëm nëse është vërtet e nevojshme. Sipërfaqet, çelwsat, dorezat e dyerve dhe dritareve, si dhe infrastruktura e WC-ve dhe lavamanet pastrohen në intervale të rregullta.

Mësimet, notat dhe çertifikatat

Mësimet do të zhvillohen përsëri në klasa sipas kurrikulës dhe tabelave të orareve që aplikohen. Mbi notat e raporteve vjetore për vitin shkollor aktual, rregjistrimet e performancës do të merren parasysh që prej fillimit të vitit shkollor më 12 Gusht 2019 deri në 13 Mars 2020, duke përfshirë dhe mësimet e rregullta të shkollës nga 11 Maji deri në fund të vitit shkollor. Të gjitha vendimet mbi shpërndarjen e çertifikatave do të bazohen në bazë të rezultateve vjetore.

Marrja e kujdesit & informacionet shtesë

Me rifillimin e mësimit në shkolla, masat e përkohshme mbi kujdesin për fëmijët do të jetë që prej 11 Majit.


Informacione të mëtejshme dhe për pyetjet më të shpeshta që ju mund të keni konsultohuni me faqet e mwposhtme:

Zyra Federale e Shëndetësisë (BAG): www.bag.admin.ch

Kantoni Aargau: www.ag.ch/coronavirus

Ju falenderojmë përzemërsisht për mbështetjen që ju u keni dhënë fëmijëve tuaj gjatë zhvillimit të mësimit në distancë si dhe për bashkpunimin e mirë dhe mirkuptues me shkollën tonë. Me këtë situatë ne kryejmë një kontribut të rëndësishëm, mbi edukimin e fëmijëve dhe të rinjve, edhe në këto situata të jashtëzakonshme.

Përsëndetje të përzemërta

A handwritten signature in blue ink, appearing to read 'A. Hürzeler', with a stylized flourish at the end.

Alex Hürzeler, Këshilli qeverisës